

Etika për fëmijë

Dhurata e përmuajtshme, nga revista "Etika"

Viti 2 - Numri 23 - Nëntor 2012

*Germat rendën nëpër udhë...,
Në një mal shqipen takuan...,
Na u bënë germat Flamur,
Në Flamur follenë ndërtuan...*

SI TË MUNDËSH MIKROBET!..

Çarë Tashgetiren

Dimri po vjen. Ftohja e motit sjell me vete edhe shfaqjen e plot sëmundjeve. Veçanërisht ata që janë të ndjeshëm ndaj të ftohtit dhe kanë trup të dobët, kanë më shumë ftohtë dhe sëmuren më shpesh.

Kur sëmuremi, shkojmë te mjeku. Ai na viziton dhe mundohet të gjejë shkakun e sëmundjes sonë. Nëse është e nevojshme na jep ilaçe. Ilaçet janë mjete të luftës kundër sëmundjes.

Askush nuk do të sëmuret e të marrë ilaçe. Por, veçanërisht në këto ditë fundvjeshte, kur koha është freskuar së tepërmi, shpesh bie shi, ne duhet të marrim masa për të mos u sëmurë.

Në fakt, ne jetojmë në një mjedis të mbushur me miliona mikrobe, baktere dhe viruse, të cilat shkaktojnë sëmundje. Këto mijëra mikrobe vazhdimisht përpiqen që të hyjnë në trupin tonë. Nëse ato nuk përballen me asnjë pengesë, mund të na sëmurin shumë lehtë.

Trupi ynë zotëron një mekanizëm mbrojtjeje të mrekullueshëm kundra këtyre mikrobeve. Ai quhet "sistemi imun". Në sajë të këtij sistemi, trupi ndjen sulmin e mikrobeve që vjen nga jashtë dhe fillon të luftojë me to. Nëse trupi fiton, ato mikrobe nuk gjejnë mundësinë për t'u vendosur në trup. Por nëse trupi nuk ia del mbanë në këtë luftë, atëherë fillojnë e shfaqen sëmundjet.

Për të qenë i fortë ndaj sëmundjeve, ne duhet të forcojmë sistemin tonë të mbrojtjes. Për ta arritur këtë, duhet të ushqehemi në mënyrë të shëndetshme dhe të ekuilibruar.

Çdo frut, perime apo ushqim tjetër, është krijuar me një qëllim. Pra, Allahu çdo ushqim e ka krijuar për të plotësuar një nevojë të caktuar të njeriut.

Mendonin një mandarinë. E merr, e qëron, e ndan dhe... më në fund e ha. Për ne është diçka shumë e lehtë dhe e këndshme. Nëse na e do xhani, e hamë, por nuk mendojmë fare për dobinë që ka mandarina në trupin tonë. Ndërkohë që ajo është një frut dimëror, që me anë të vitaminës C na ruan nga sëmundja e gripit.

Çdo frut apo perime, ka të paktën nga një dobi të veçantë për njeriun në stinë në të cilën ajo piqet. Shalqiri na shuan etjen në ditët e nxehta të verës dhe plotëson nevojat tona të sheqerit. Gjatë dimrit, portokalli, limoni, mandarina, nerënxa etj., na ruajnë ndaj të ftohtit.

Detyra jonë është që në çdo stinë të hamë pa bërë naze të gjitha frutat dhe perimet e asaj stine. Trupi ynë merr prej tyre çdo gjë që i nevojitet. Këto ushqime na forcojnë.

Një trup, i cili, ngelet pa mbrojtje, mund të sëmuret qoftë edhe nga një mikrob i vogël e që në dukje ndoshta duket i parëndësishëm. Ndërsa përballë një trupi të fortë, mikrobet nuk mund të bëjnë asgjë.

Për ta forcuar sistemin tonë të mbrojtjes, duhet të bëjmë

gjithmonë një jetë të shëndetshme. Të ushqehemi rregullisht dhe me ekuilibër, të flemë mjaftueshëm, të lëvizim, të merrëmi me sport, të tregojmë kujdes ndaj pastërtisë, të jemi të lumtur dhe të gëzuar. Të gjitha këto na ndihmojnë edhe të jetojmë bukur edhe të ruheni nga çdo lloj sëmundjeje.

Trupin tonë e kemi amanet prej Allahut. Prandaj dhe kujdesi ndaj tij është detyra jonë. Nëse mendojmë për shëndetin dhe lumturinë tonë, duhet t'i vëmë veshin këtyre këshillave dhe duhet t'i njohim e t'i zbatojmë të gjitha rregullat për një jetë të shëndetshme.

Për t'u mbrojtur nga gripi:

1- Lajini duart me sapun dhe shpesh.

2- Mos i fërkoni sytë, hundët dhe gojën me duar të papastura.

3- Mos iu afroni shumë shokut tuaj që është i sëmurë dhe kollitet. Gripi është një sëmundje që ngjitet shumë lehtë.

4- Portokalli, mandarina, limoni dhe nerënxa janë armët tona më të mira kundër mikrobeve. Prandaj, duhet të hamë të paktën dy prej këtyre frutave në ditë.

5- Edhe perimet dimërore, si: preshi, spinaqi, pazia, lulëlakra dhe karota duhen ngrënë pa bërë asnjë dallim.

6- Mos e lini pa ngrënë vaktin e mëngjesit.

7- Konsumoni sasi të mjaftueshme qumështi dhe kosi.

8- Në vend të pijeve me gaz pini lëng frutash ose dhallë.

9- Qëndroni larg prej ushqimeve të gatshme të llojit xhups, hamburger, etj.

10- Mos bëni dallim në ushqime dhe hani të gjitha ushqimet që ju përgatitmamaja.

M o s
h a -
rroni se
çdo ushqim është një shërim më vete për trupin tonë.



GJUHA SHQIPE

**Vëllezrë Shqipëtarë!
Qasuni më dëgjoni,
Sa të muntni më parë
Gjuhën tuaj mësoni
Pa shihni sa 'sht' e mirë!
S'u vjen mall e dëshirë?**

.....
**Se gjuh' e Shqipërisë
Është e Perëndisë.**
.....

**Ju shkëmbenj e ju male,
Ju brinja e bregore,
Dhe ju lumenj ngadalë,
Ju fusha gjelbërore,
Shqip të flisni, përherë!**
.....

**Dhe vetë Perëndija,
Edhe Zot'i vërtetë,
Dh'e tërë gjithësija
Këtë gjuhë të ketë,
Këtë dhe Shqipëtarë,
Shpirtmadhi, punëmbari.**

EMËR' I ZOTIT

**Zot i vërtetë!
Bota e tërë,
Gjithë ç'ke bërë
E ç'ka në jetë,
Të gjitha ç'janë,
Yj edhe diej,
E dhë e qiej,
Një gjuhë kanë,
Që thot' Emrin Tënt!
Ngado që shikonj,
At' Emër dëgjonj,
E shoh' më çdo vënt.**

Naim Frashëri

**Etika
për fëmijë**

Drejtor
& Kryeredaktor:
Alban Kali
albankali@yahoo.com
+355 69 24 23 989

Redaktor:
Xhahid Bushati
xhahidbushati@yahoo.com
+355 69 28 20 975

Redaktore gjuhësore:
Dr. Irida Hoti
Përkthyes:
**Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha**

Dizajn - Grafik:
Bledar Xama
bledar_xama@hotmail.com

Adresa: L: Vasil Shanto - Rr: Çajupi - Shkodër - Albania / Tel: +355 22 254 634 / Fax: +355 22 254 633
Zyra e përfaqësimit Maqedoni: Rr: Stiv Naumov - Nr. 9 - lokal 25 - Shkup - Maqedoni / Tel: +389 71 956 271
Zyra e përfaqësimit Kosovë: Rr: Ardian Zurnaxhiu - pn. Ralin - Prizren - Kosovë / Tel: +381 29 222 795

E VOGLA ABETARE!..

1.

*Vitet ikën, ja, u rrita...
Iamtumirë, fëmijëri!..
Ty, e vogla ABETARE
Të kujtoj me dashuri...*

*Një fole me germa shqipe
Ti i fale shpirtit tim...,
Kurrë shpirti të mos vyshket,
Ti ngjaj pyllit me gjelbërim...*

2.

*Nëpër shekuj germat shqipe
Sa shtegtuan nëpër udhë!..
I zu nata, u bënë dritë,
Shqipja-germë e pagjumë!..*

*Nuk u lodhën, prapë shtegtuan
Germat shqipe, shqipet fjalë!
Folën herë si lule vjollca,
Herë si gjyshe zemërbardhë!*

*Gjyshet, gjyshet zemërbardhë
Rrudha vetes i kanë falë
Për një nip e për një mbesë,
Gjyshja - diell i vërtetë!..*

*Gjyshet, gjyshet zemërbardha,
Shpirt' i tyre ngjan si male...
Gjyshet, gjyshet fjalë urta
A nuk ngjajnë si Abetare?..*

*Folën-folën, kurrë s' u lodhën!..
Folën-folën, zemra ngrohën!..*

3.

*Nëpër shekuj germat shqipe
Sa shtegtuan nëpër udhë...,
I zu nata, u bënë dritë,
Sa u gdhendën në ninullë...*

*Ecnin, ecnin, ndjenin mall...,
U bënë vjershë dhe përrallë...,
U bënë zogj lajmëtarë,
U bënë yje dhe pishtarë...*

*Dhe shtegtuan nëpër udhë...,
Dhe në pyje shpesh pushuan,
U bënë lapsa dhe fletore
Jetës - jetë, i dhuruan..!*

*Dhe shtegtuan nëpër udhë...,
Në një mal shqipen takuan...,
Na u bënë germat Flamur,
Në Flamur folenë ndërtuan...*

*Një fole që ndrit veç ndrit...
Germa shqipe, Shqipja-dritë!..*

4.

*Ë shpesh kokën pas e kthej
Shoh një ëndërr, shoh një gjurmë,
Diku larg shoh Abetaren
Doçkat ëmbël seç m'i tund...*

*Harroj vitet përmbi supe,
Nis bisedën përsëri...
Abetarja lehtë më thotë:
"Paske mbetur prapë fëmijë..!"*

MUND TË MARRËSH CILINDO LIBËR QË DËSHIRON QË TA LEXOSH

Hymejra Meriç

Zotëri Aliu punonte në bibliotekën kom-
bëtare të qytetit. Punonte që prej 18 vitesh.
Fëmijët e thërisnin “Xhaxhi Aliu”. Të gjithë e
donin dhe e respektonin. Përpiqej të ndih-
monte lexuesit dhe mendohej t’ua realizon-
te dëshirat e tyre në mënyrën më të mirë
të mundshme. Ato libra që nuk gjendeshin
në bibliotekën e tij, pyeste në

bibliotekat e tjera, dëshi-
ronte që t’i gjente me
doemos, nuk donte
që ata që
vinin t’i


kthente duarbosh.

Biblioteka ishte shumë e pasur, duke
pasur parasysh se ishte një bibliotekë e
një qyteti të vogël. Në rafte gjendeshin me
qindra libra të ndryshëm. Natyra e dashur
e Zotëri Aliut u pëlqente të gjithëve, veça-
nërisht fëmijëve. Për miqtë e librit, ky ishte
vendi i Diturisë.

Veçanërisht, për arsye se biblioteka ish-
te në qendër të qytetit, ky vend ishte bërë
vendi i takimit të nxënësve të shkollave fi-
llore, 9-vjeçare, të mesme dhe të studen-
tëve të universitetit. Të rinjtë uleshin aty dhe
ndanin me njëri – tjetrin njohuritë që kishin
marrë nga librat që kishin lexuar.

Një ditë, Zotëri Aliu, kur po
rregullonte raftet, vuri re
se mungonin disa libra. I
shqetësuar, menjëherë pa
fletoren e regjistrimit. Shi-
koi në kompjuter, te pjesa
e librave të dhënë hua, për
librat që nuk gjendeshin në
rafe. U shqetësua shumë
kur pa që në regjistra, nuk
shënohej asgjë për ato
libra. Filloi të mendonte:
“...Se mos ia kam dhënë
ndokujt, dhe nuk i kam re-
gjistruar në kompjuter?”

U bë natë. E mbylli de-
rën e bibliotekës i mërzhitur
shumë dhe u nis për në
shtëpi. Rugës, teksa po
shkonte në shtëpi, herë i
vinte në mendje dashuria
që kishin lexuesit për librat



dhe herë mendonte se ku mund të ishin librat që kishin humbur... Nuk arrinte ta shpjegonte. Po çfarë kishte ndodhur, vallë?!..

Ditët kalonin. Zotëri Aliut nuk i largohej mërzia. Edhe buzëqeshja i kishte humbur...

Një ditë pa që po hynte në bibliotekë një djalosh me një thes në shpinë. U çudit. Nuk ishte diçka e natyrshme një hyrje e tillë me thes, në bibliotekë. Vetëm e vështroi. Djaloshi vendosi thesin në një anë. U afrua drejt tij me një fytyrë të turpëruar. Ishte djersitur dhe... sikur merrte frymë me vështirësi.

Pasi e vështroi disa herë në sy Zotëri Aliun, i tha:

- Më falni, desha t'ju thosha diçka...

- Po, urdhëroni, dëshironi ndonjë libër?!.. Ju ndihmoj menjëherë...

- Jo..., në fakt desha t'ju thosha diçka tjetër...

- Urdhëroni, flisni...

- Zotëri, ju kërkoj shumë shumë ndjesë!..

- Mua?!.. Ç'ne, përse?!.. Ç'ka ndodhur?!..

- Ai thes që shihni aty, është plot me libra. Ato libra unë i kam marrë nga kjo bibliotekë.

Sytë e Zotëri Aliut sikur u zmadhuan një çast. Sikur... s'i besohej... E pyeti:

- Po... si ndodhi?!..

- Thjesht, Zotëri. Sa herë vija, merrja nga një libër, pa ju lajmëruar juve. Ose më saktë, i kam... (atë fjalë nuk mundi ta shqiptonte). Librat i kam çuar në shtëpi. I kam lexuar të gjithë. Nga ato që kam mësuar, kam kuptuar që ajo çfarë po bëja, nuk ishte veprim i drejtë. Nuk ishte një sjell-



je që i shkonte një njeriu, veçanërisht një myslimani. Mendova se isha në rrugën e gabuar. Duhej të hiqja dorë nga ky veprim. Ndaj, dhe i solla të gjithë librat që i kisha marrë pa leje. Ju kërkoj shumë ndjesë dhe ju kërkoj të ma bëni hallall!..

Zotëri Aliu mbeti i shtangur përballë fjalëve që foli i riu. U mendua, dhe me një maturi të madhe e i buzëqeshur, i tha:


- Veprimi juaj ka vlerë dhe të nderon, ty djalosh. Ti, në saje të këtyre librave, ke kuptuar se ke bërë një veprim të gabuar. Dëgjo, djalosh, tashmë, ti mund të marrësh cilindo libër që dëshiron ta lexosh. Dera e bibliotekës për ty rri gjithnjë hapur.

Djaloshi vështroi Zotëri Aliun dhe i vinte ta përqafonte. Sa të vështirë e kishte menduar takimin me të. Sa i lehtë i doli. Kështu është, kur jeton mes librash...



Një mësim nga mësimet e Hadithit

- pjesa e tetë -



ATË DITË NË BUFENË E SHKOLLËS KISHTË SHUMË NXËNËS. SAMIU I VOGËL ISHTË NË RADHË. PAS NJË PRITJEJE TË GJATË, I ERDHI RADHA.



Hej, hej!
Çfarë po
ndodh këtu?!

KUR PO I THOSHTË XHAXHI SHITËSIT ATË QË DËSHIRONTE, BEFASISHT NXËNËSIT FILLUAN TË BËRTISNIN NJËRI-TJETRIT.



Përse përpiqesh të hysh pa
radhë? Futu në radhë!

E kam urgjente të
thashë, më kupto...



Shiko! Mos më nxe
mua, se përndryshe...

Hë, çfarë do të bësh
nëse nxelesh?! Nuk
kam frikë fare...





Hej, shiko pak!

NË PUSHIMIN TJETËR...



Nuk të falënderova dot.



Përse e bërë një gjë të tillë?



The se pate një punë urgjente?..

Kështu, dhunon të drejtën e shokut.




Unë do të merrja thjesht një çokollatë. Nuk do më gjente gjë edhe sikur të mos e haja atë.



Faktikisht edhe unë do të merrja vetëm një çokollatë.

“KUSH I SHKAKTON DËM NJË MYSLIMANI, EDHE ALLAHU I SHKAKTON DËM ATIJ. KUSH E FUT NË VËSHTIRËSI APO NË TELASH NJË MYSLIMAN, EDHE ALLAHU I JEP ATIJ VËSHTIRËSI, TELASH DHE VUAJTJE.”
(HADITH FISNIK)



SAMIU I VOGËL U BË SHOK I NGUSHTË ME FATMIRIN. SAMIU FILLOI TË TREGOJË FATMIRIT HADITHET QË KISHTE DËGJUAR NGA PRINDËRIT NË LIDHJE ME ÇËSHTJEN E TË DREJTËS SË ROBIT.

“KUSH I BËN PADREJTËSI DIKUJT DHE I DHUNON TË DREJTËN, LE TË KËRKOJË HALLALLËK PARA DITËS SË KIAMETIT NË TË CILËN NUK DO TË KENË VLERË PARATË. PRA, MOS TA LËRË KËTË PËR NË AHIRET. NËSE KJO ÇËSHTJE NGEL PËR NË AHIRET DHE DHUNUESI KA VEPRATË TË MIRA, I MERRET SEVAP AQ SA KA BËRË PADREJTËSI DHE I JEPET ATIJ QË ËSHTË BËRË PADREJTËSI. NËSE DHUNUESI NUK KA NDONJË SEVAP, I JEPET NJË PJESË PREJ MËKATEVE TË ATIJ QË ËSHTË BËRË PADREJTËSI.”
(HADITH FISNIK)



Mysafiri

Hamdiu po lozte në bahçe, kur pa një plak me mjekër të bardhë që po ecte me hapa të vegjël. Plaku ndaloi për të pushuar pak te porta e bahçes së shtëpisë dhe i tha Hamdiut:

- Bir, a mund të rri një natë në këtë mysafirhane?

Hamdiu qeshi dhe i tha:

- Kjo nuk është mysafirhane, xhaxha.
- Meqë nuk qenka mysafirhane, çfarë është atëherë?
- Është shtëpia jonë.
- Ashtuu?! Shumë mirë, po kush e ka bërë këtë shtëpi?
- Gjyshi im.
- Kujt i ka ngelur pas gjyshit?
- Babait tim.
- Pastaj kujt do t'i ngelë?
- Mesa duket mua.

Plaku e pa duke qeshur Hamdiun dhe i tha:

- Meqë pronarët e kësaj shtëpie ia kanë lënë atë të tjerëve, atëherë të gjithë ju, mysafirë jeni, biri im. Pastaj u largua me hapa të avashtë.

Kur filloi shkolla, në orën e mësimi të kulturës fetare të gjithë po tregonin kujtimet dhe ngjarjet më mbresëlënëse të pushimeve. Kur i erdhi radha Hamdiut, ai tregoi për bisedën e çuditshme që kishte bërë me plakun me mjekër të bardhë.

Disa prej fëmijëve iu dukën të pakuptimta fjalët e plakut, prandaj mësuesi për t'ia shpjeguar më mirë, u kujtoi këtë hadith të Pejgamberit tonë (a.s.):

“Lidhja ime me këtë botë është si ajo e një udhëtari, i cili, pasi pushon nën hijen e një peme, vazhdon rrugën.” (Tirmidhi, Zuhd, 44)



Fitan i treti...

Luani dhe ariu, të tërbuar nga uria, panë një qengj bardhosh teksa kulloste në një lëndinë të bukur në mes të pyllit. Goja iu shkoi lëng. Secili po mendonte për vete se si ta kapte sa më parë gjahun dhe të siguronin një drekë të shijshme.

Filluan të grinden me njëri-tjetrin.

- Unë e pashë i pari, më takon mua! - tha ariu.

- Unë mbërrita i pari, është i imi! - ia priti luani.


- Atëherë le të luftojmë! Ai që e mund tjetrin do fitojë qengjin. - i thanë njëri-tjetrit dy konkurentët.

Filloi një betejë e ashpër. Sulmonte luani, ariu mbrohej. Godiste ariu, luani zmbrap-sej. Ndërsa dy kafshët vazhdonin betejën, papritur nga një kaçubë na doli një dhelpër sygjelbër. Ajo u afrua me kujdes, pa zhurmë dhe dinakëri. Kur luani me ariun ishin mbërthyer keqas me njëri-tjetrin e nuk mund të shqiteshin dot, dhelpëra kapi rrufeshëm qengjin dhe ia mbathi. Luani dhe ariu, kur panë se qengji nuk ndodhej pranë tyre, mbetën të shtangur. Hodhën sytë, dhe diku panë dhelpërën që shtrëngonte qengjin e po ia mbathte me të katra.

- Ç'budallenj paskemi qenë, në vend që ta ndanim përgjysëm gjahun dhe të mbe-teshim miq, luftuam kundër njeri-tjetrit dhe nuk fituam asgjë, - tha ariu.

- Lakmia dhe inati na i verboi sytë e mendjes! ...Kështu ne mbetëm pa qengj... - ia priti luani.

Lexuesi im i dashur! I Urti na këshi-llon që ta duam, të ndihmojmë njëri-tjetrin dhe të pajtohemi në arritjen e qëllimeve tona të larta, përndryshe nëse harrojmë qëllimet dhe merremi me njëri-tjetrin si në historinë e për-rallës sonë, një i tretë do të triumfojë ndaj nesh ...Por, nëse nuk tregohesh i drejtë ndaj vetes, nuk mund të jesh i drejtë as ndaj tjetrit.



Uji, zjarri dhe njeriu

1.

Na ishte një herë një kohë shumë e vjetër. Njerëzit nuk dinin asgjë, as sa bënin 1+1. Por ato njerëz ishin të etur për ujë, ndonëse nuk ia dinin kuptimin kësaj fjale.

Një ditë, ata panë një njeri që dukej sikur po vdiste në det. Ai zhytej, pinte ujë dhe dilte i gjallë mbi sipërfaqen e detit. Njerëzit të habitur nga kjo skenë, dëgjuan më vonë nga goja e tij historinë që i kishte ndodhur... Që nga ajo ditë ata e quajtën ujin SHËRUESI.

2.

Po afrohej dimri. Ishte një dimër i egër. Njerëzit sëmureshin ditë pas dite. Tani as uji nuk u bënte dobi. Por një ditë ndodhi një çudi me dy fëmijë që po rrinin pranë një peme. Papritur ndriçoi një vetëtimë e zjarrtë. Pema mori flakë. Fëmijët u ngrohën nga zjarri i vetëtimës. Më pas, ata shkuan për t'u treguar njerëzve se çfarë u ndodhi, por ato nuk u besuan.

3.

Janari erdhi aq i acartë, sa disa njerëz dukeshin se po vdisnin. U merrej fryma. Nuk kishin fuqi të rrinin në këmbë. Sytë i mbanin gjysmë të hapur e gjysmë të mbyllur.

Për t'i shpëtuar njerëzit, dy fëmijë dhe dy të rritur vendosën të bënin një zjarr të madh, që njerëzit të ngroheshin. Ata, vërtet, u ngrohën, por dhe shpëtuan.

Që nga ajo ditë UJIN e ZJARRIN filluan t'i quanin gjërat më të rëndësishme në jetën e tyre.




Çfarë? Përse? Si?

Zehra Aksoy

PËRSE KAKTUSET KANË GJEMBA?

Gjethet e bimëve mundësojnë thithjen e gazrave të nevojshëm dhe nxjerrjen e ujit jashtë në formë avulli. Por në gjethet e disa bimëve, kanë dalë disa gjëra të veçanta strukturore. Për shembull: Gjembat në bimën e kaktusit luajnë rolin e gjethëve. Për shkak të këtyre gjembave, ruhet shtresa e ajrit përreth bimës dhe në këtë mënyrë pakësohet humbja e ujit. Veçanërisht, te bimët e lëngshme, mbajtja e klorofilit, i cili është i nevojshëm për rritjen dhe zhvillimin e bimës, realizohet me anë të këtyre gjembave.



SI JANË NGJYRAT E PALLOIT?

Pendët ngjyra-ngjyra të palloit që formohen nga 150 sy, faktikisht janë ngjyrë kafe, por pendët ngjyrë kafe janë krijuar në atë mënyrë saqë shfaqen si një ylber i ndryshëm me ngjyrat e bakrit, bronzit, floririt, ngjyra të gjelbra dhe manushaqe. Fshehtësia e kësaj tabloje madhështore e nxjerr në pah vetëm duke përdorur ngjyrën kafe, e cila qëndron në boshllëqet që janë sa një e njëmijta e simetrisë në shtresat e keratinës që është lënda kryesore e pendëve. Këta boshllëqe e reflektojnë dritën dhe formojnë ngjyra të ndryshme. Ndërsa pranë boshllëqeve gjenden pigmentet ngjyrë kafe, të cilat quhen “melaninë”. Pamja që formohet nga melanina ngjyrë kafe dhe keratina boshe, shfaqet në formën e palloit të pashoq me afërsisht 150 sy para syve tanë.



SA ËSHTË GJATËSIA E DAMARËVE TANË?

Specialistët kanë pohuar se gjatësia e të gjithë damarëve në trupin tonë është 160.000 km. Domethënë, kanë një gjatësi që mund ta rrethojnë botën jo një herë, por katër herë. Ndërsa shpejtësia e qarkullimit të gjakut dhe arritja e tij te organet e indet e ndryshme, realizohet me shpejtësi të ndryshme dhe sipas një sistemi të ndërlikuar. Për këtë arsye, nuk mund të bëhet një kaktim i përgjithshëm se një rruazë e kuqe gjaku lëviz me këtë shpejtësi në sekondë. Megjithatë mund të thuhet se i gjithë gjaku në trupin tonë, brenda disa minutave qarkullon në të gjithë sistemin dhe plotëson furnizimin me oksigjen.



MUSTAFA JAZGAN


ABBAS BIN FIRNASI

**Shkencëtari, që 1000 vite para vëllezërve Wright,
realizoi fluturimin duke bërë aeroplanin e parë**

Fëmijë të dashur të Etikës për fëmijë!

A ju ka ndodhur që, kur luani në park ose shikoni qiellin nga dritarja, të keni parë zogj që fluturojnë në qiell dhe të keni thënë: “Ah! Sikur të fluturoja edhe unë sikur këta zogj... Sikur të kisha edhe unë krahë... Të kisha mundësi të fluturoja nga një vend në tjetrin?” Kjo dëshirë nuk ju përket vetëm ju, kjo gjë ka qenë një dëshirë serioze e njerëzve gjatë gjithë historisë së njerëzimit. Gjithnjë e kanë ëndërruar... Nuk e di nëse ka pasur prej atyre që, për të realizuar këtë ëndërr, si pasojë e kureshtjeve joshkencore, janë hedhur nga çatia apo muri dhe që të kenë mbetur të pajetë apo të gjymtuar. Por, në historinë e shkencës, ka pasur shkencëtarë që kanë bërë provë në mënyrë shkencore dhe që ia kanë dalë të bëjnë fluturimin e parë.

Kujdes, plot 1000 vite përpara se vëllezërit Wilbur dhe Orville WRIGHT, që njihen si njerëzit e parë që ia dolën me sukses të fluturonin duke bërë aeroplanin e parë në Evropë; në vitin 1903, shkencëtari mysliman i Andaluzisë, Ebul-Kasim Abbas bin FIRNAS bin Verdus, në vitin 880, kishte bërë një mekanizëm që nuk ishte parë deri në atë kohë. Ky mekanizëm, ishte i veshur me pëlhurë, me një sipërfaqe të gjerë dhe me krahë. Duke i vënë edhe pendë shpendësh, Ibn Firnasi ka arritur me sukses provën e parë të fluturimit në histori, megjithëse me disa të meta të vogla.





E çfarë kishte ndodhur? Për arsye se nuk kishte vënë pjesën e “bishtit” në mjetin që kishte bërë, zbritja në tokë kishte qenë shumë e fortë dhe e vështirë, saqë kishte rrezikuar jetën.

Historia e shkencës e regjistron Ibn Firnasin si njeriun e parë që fluturoi. Pra, “fluturimin e parë” sërish e paska bërë një mysliman. Vite më vonë (në vitet 980), Ismail Xhevheri ka tentuar të fluturojë, por i ka kushtuar me jetën. Në Historinë osmane, Hezarfen Ahmet Çelebiu (në shekullin 17), ka arritur të fluturojë pa incident e të meta, në Stamboll, nga Kulla e Gallatës deri në zonën e Doganxhëllar të Yskydarit. Nderin e fluturimit me një zbulim të llojit raketë e ka Lagari Hasan Çelebi (i kohës së Muratit IV.).

Shkencat dhe shkencëtarët zhvillohen si zinxhirë që ndjekin njëri – tjetrin. Faktikisht, feja Islame, që në kohën e Hazreti Ademit (a.s.), ashtu sikurse u ka mësuar njerëzve besim – adhurim- etikë dhe sjellje të qytetëruar, po ashtu ia ka shpjeguar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi “TË FSHEHTAT E GJITHËSISË”. Feja jonë e bukur, është një fe e vërtetë e shkencës, kulturës dhe njerëzimit.

Të dashur fëmijë!

Abbas bin Firnasi ka lindur në një nga fshatrat e vegjël të Takeruna-së, që ndodhet në zonën e Ronda-së së Andaluzisë. Lidhur me datëlindjen dhe jetën e tij nuk ka shumë të dhëna, por dihet se ishte një skllav me origjinë berberi, rritur në Kordoba dhe po aty është shkolluar. Në vitet e rinisë është bërë i njohur për interesin e tij ndaj filozofisë, kimisë, astronomisë dhe letërsisë. Për arsye të punimeve shkencore dhe letrare që kishte bërë, kishte fituar të drejtën të bëhej një nga dijetarët oborrtar të sarajit të Hakemit (të parë) dhe në kohën e Abdurrahmanit (të dytë) dhe të Muhamedit (të parë), kishte ruajtur të njëjtin status në saraje. Për arsye të kureshtjes dhe të karakterit prej studiuesi, Ibn Firnasi kishte bërë një glob që pasqyronte hapësirën qiellore. Kishte bërë skicat “Sindhind”, të cilat kishin ndikuar të përparonin në astronomi në Evropë. Ai, gjithashtu kishte arritur të bënte kristal nga kuarci. Ibni Firnasi ishte i dhënë sa pas shkencës së kimisë, aq edhe pas fushës së muzikës.



MENDO PAK... E BUZËQESH

Adelina R. Mamaqi

Hunda, Sytë, Goja

U tha hunda syve:
- Ç'shëm tara që jeni!
Unë jam si mal,
Ju, si pëllg liqeni!

Goja e dëgjoi
Dhe ia ktheu rrëmbyer:
- Ti, pa sytë, moj,
Do të ishe thyer!..



Mali dhe Reja

I tha malit një copë re,
Si një mal i madh me majë:
- Mos të duket sikur ç'je?
Shihmë mua sa të ngaj!

Madje, madje, edhe jam
Më e madhe se sa ti,
Majën më të lartë e kam
Në mes qiellit pa kufi!

Mal'i lartë buzëqeshi
Dhe i foli: - Re, o re,
Prit, sa t'fillojë rrebeshi,
Pa e sheh se ç'mal më je!

PAPAGALLI DHE KANARINA

Një papagall
Dëgjoi një kanarinë,
Mendo: Vallë,
Është zog a violinë?

Po, kur u bind,
Se ishte zog vërtetë,
"Oh, - tha - Kjo këngë
Mësohet fare lehtë!"

Kjo kanarina
Këndonte shpesh e shpesh,
Ky papagalli
I heshtur mbante vesh...

Së fundi thirri:
"E kam mësuar ujë!"
Dhe këngën nisi
I zhurmshëm e me bujë.

Pa hesht! - i thanë
Se ç'mende njerëzinë!
Një papagall
Nuk bëhet kanarinë.

Nastradin Hoxha





ZBAVITJE

SUDOKU!

Plotësoni çdo rresht, kolonë dhe kutizë, në mënyrë që, çdo shifër nga 1 deri te 9, të shfaqet një dhe vetëm një herë.

	7		5		8			4
								6
			4			9	8	
9	5		6		4			7
6		8		7		4		1
7			9		2		6	3
	3	2						
4					6			
			8		9		5	

Nijrose lvanin!



MACET


A i gjeni dot emrat e maceve tek tabela e mëposhtme?

LUAN | TIGËR | RRËQEBULL | PUMA | JAGUAR | LEOPARD | MACE | GETOPARD

M	K	E	O	P	L	G	E	N	S	G	H	D
C	L	H	R	T	E	O	C	M	I	A	B	M
L	A	U	A	B	O	C	N	G	U	T	G	A
L	S	I	A	B	P	E	E	E	O	I	A	C
U	R	V	C	N	A	D	Q	T	M	N	F	E
B	N	A	V	B	R	E	A	O	V	Y	O	K
E	M	R	U	L	D	T	K	P	Z	U	R	O
Q	B	A	A	N	M	O	H	A	O	I	R	A
Ë	U	K	Q	S	A	C	S	R	P	P	E	F
R	T	B	N	Q	V	P	E	D	O	U	Y	G
R	T	I	G	Ë	R	O	P	E	D	E	M	I
F	Z	R	A	U	G	A	J	E	H	J	K	A




Gjej 7 ndryshimet!





Ndihmojeni Ketrin
e vogël të gjejë
lajthinë...



Të gjitha figurat e
mësipërme
janë vendosur dy herë,
përveç njërës.
A e gjeni dot
cila është ajo?









Erldhi një mik i ri!
Ju fton
miqësinë e tij...



- Tak, tak, tak!
Shkurti troket...



Lexo...



Sa shumë të
o Profeti ynë i



pyll, në piknik
gjyshin.



Sbkollë,
mirupafshim,
du të vijmë prapë si lule!



Vera i merr me vete,
Fëmijët në male e dete!



TË GJEJME
DASHURI!...



Të jesh mik i mjedisit
është virtyt!
Eja, fitoje edhe ti!...



Kush dhuron, fal dashuri,
s'behet vonë, kurrë, o fëmijë!



Dëbora është
Mirë s